

LIGJ
Nr.7588, datë 15.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7548, DATË 8.1.1992 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7548, datë 8.1.1992 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 shtohen paragrafët që vijojnë:

- "... taksë për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë me avion";
- "... taksë për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti";
- "... taksë për shfrytëzimin e lëndës drusore";
- "... taksë për fjetjen në hotele të të huajve";
- "... taksë për pajisje me pasaportë lundrimi".

Neni 2

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1- "Për taksat lokale" pas shkronjës "b" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Taksat e regjistrimit të personave juridikë a fizikë që paguhet në valutë të lirë derdhen në llogarinë valutore të Drejtorisë së Tatimeve".

2- "Për taksat nacionale", pas shkronjës "f", shtohen:

"g" për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë me avion për të udhëtuar në shtetet e tjera, nga shtetasit e huaj paguhet një taksë prej 10 dollarë USA për çdo kalim dhe për shtetasit shqiptarë 500 lekë për çdo kalim.

"gj" Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti caktohet 1000 lekë për dëshminë e grupit A, B dhe F. Për marrjen e dëshmimeve të tjera taksa paguhet në masën 50 për qind e shumës së mësipërme.

"h" Taksa për shfrytëzimin e lëndës drusore caktohet për çdo ndërmarrje nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, dhe derdhet në buxhetin e shtetit.

"i" Taksë për fjetjen në hotele caktohet 10 dollarë USA për çdo natë fjetjeje vetëm për shtetas të huaj dhe përfshihet në çmimin e fjetjes në hotel.

Shkronjat "b", "c", "ç" dhe "dh" për taksat lokale të nenit 7 ndryshojnë përkatësisht si vijon:

"b" Taksa vjetore e regjistrimit për veprimtari të ndryshme caktohet si më poshtë:

Për veprimtaritë private 100 lekë për personat fizikë vendas dhe 1000 lekë për personat juridikë vendas. Për ndërmarrjet me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj ose vetëm të huaj dhe për investimet e huaja 1000 dollarë USA, kurse për zyrat e përfaqësimit të ndërmarrjeve të huaja 500 dollarë USA. Për personat fizikë shqiptarë me të huaj (ortakëri) 1000 lekë, kurse për personat fizikë të huaj 200 dollarë.

"c" Taksa e regjistrimit për ushtrimin e llotarive, të konkurseve parashikuese dhe të lojrave të fatit caktohet 5000 lekë në vit.

"ç" Taksa e pastrimit caktohet 10 lekë në vit për çdo familje dhe 50 lekë në vit për personat juridikë a fizikë.

"d" Taksa e tregut për zënie vendi caktohet 30 lekë për metër katror për çdo ditë. Taksa e tregut për peshëmbajtje dhe kontrollin e mjeteve matëse caktohet 10 lekë për çdo ditë.

"dh" Taksa për lëshimin e lejes vjetore të gjuetisë 5000 lekë në vit.

"e" Për personat juridikë a fizikë të huaj, taksa e gjuetisë së peshkimit dhe kafshëve e shpendëve caktohet me akte të veçanta nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

"ë" Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi caktohet 500 lekë në vit.

Neni 3

Në nenin 8, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Taksat arkëtohen nga organi që kryen shërbimin. Në këto raste organet shtetërore veprojnë si agjentë të organeve tatimore për mbledhjen e taksave. Personave juridikë shtetërorë dhe personave juridikë a fizikë privatë të ngarkuar me nxjerrjen e taksave, ju lihet 5 për qind e masës së taksave të vjela".

Neni 4

Shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

Sipas llojit të taksave organet që ngarkohen me nxjerrjen e taksave janë:

A. Për taksat nacionale

a) Për taksat portuale dhe për pajisjen me pasaportë lundrimi pajisen kapiteneritë e porteve.

b) Për taksat për shërbimet konsullore ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Rendit Publik, sipas ndarjes që do të përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë.

c) Për taksën e qarkullimit të automjeteve ngarkohet inspektorati rrugor i Ministrisë së Rendit Publik dhe degët e doganave në pikat e kalimit të kufirit për automjetet e huaja.

ç) Për taksën për përdorimin e aparateve televizive ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike në varësi të ndërmarrjeve elektrike.

d) Për taksën për përdorimin e aparateve telefonike ngarkohen degët e PTT-ve.

dh) Për taksat për kryerjen e veprimeve gjyqësore e noteriale ngarkohen gjykatat dhe zyrat e noterisë.

e) Për taksën në regjistrimin në arsimin e lartë ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta.

ë) Për taksën për radiokomunikacionin privat ngarkohet Komisioni Shtetëror i Radiokomunikacionit.

f) Për taksën për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë me avion ngarkohen organet doganore.

g) Për taksën për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti ngarkohet inspektorati rrugor i Ministrisë së Rendit Publik.

gj) Për taksën për shfrytëzimin e lëndës drusore ngarkohen organet që caktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

h) Për taksën për fjetjen në hotele të të huajve ngarkohen hotelet, pensionet shtetërore ose private.

B. Për taksat lokale

a) Për taksën e shërbimeve me karakter administrativ ngarkohen organet që kryejnë shërbimin.

b) Për taksën e regjistrimit për veprimtari të ndryshme ngarkohen përkatësisht degët e tatimeve në rrethe dhe Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

c) Për taksën e pastrimit ngarkohen ndërmarrjet komunale që ushtrojnë veprimtarinë e pastrimit të qyteteve.

ç) Për taksën e tregut për zënie vendi për peshëmbajtje e kontrollin e mjeteve matëse ngarkohen organet e pushtetit lokal, në komuna, bashki e rrethe.

d) Për taksën e gjuetisë ngarkohet Shoqata e Gjuetisë.

Neni 5

Në fund të nenit 9 shtohen fjalët:

ç) Qarkullimi i automjeteve të institucioneve buxhetore, ndërmarrjeve shtetërore të transportit urban që subvencionohen nga shteti, automjetet e huaja që sjellin ndihma shtetërore, humanitare, mjetet e shoqërive të ndryshme bamirëse, institucioneve fetare dhe të Shoqatës së të Burgosurve Politikë.

Neni 6

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Shkeljet e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë 1000 deri në 3000 lekë, duke marrë edhe taksën në vlerën e saj të plotë.

Neni 7

Në paragrafin e parë të nenit 12 para fjalëve: "tatimeve në" shtohen fjalët "komuna, bashki e..." dhe pas fjalëve në "Ministrinë e Financave" shtohen fjalët "dhe "Ekonomisë".

Në paragrafin e dytë fjalët "te përgjegjësi i Seksionit të financës në rreth" zëvendësohen me fjalët "te kryetari i zyrës së tatimeve e taksave në komunë e bashki, te kryetari i degës së tatimeve e taksave në rreth".

Neni 8

Lidhjet 1, 2 e 3 të ligjit nr.7548, datë 8.1.1992 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", zëvendësohen me lidhjet 1, 2 e 3 që i bashkëngjiten këtij ligji.

Në lidhjen nr.4 të ligjit nr.7 548, datë 8.1.1992, në shkronjën "E", pika 7 shfuqizohet.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 5 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.260, datë 20.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

NIVELI I TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Taksa në dollarë

Për çdo ton neto të re- gjistrimit anijeve	Gjithsej për çdo anije
---	---------------------------

LLOJI I TAKSAVE

TAKSAT PORTUALE

1. Taksë e zakonshme anijeje:

— Për anijet që ngarkojnë ose shkarkojnë mallra	1.0
— Për anijet e udhëtarëve e trageti	0.6
— Për anijet sportive (motoskaf)	0.4
— Për anijet e transportit të tregtisë kufitare	0.4

2. Taksë me zbritje të anijes:

— Për të gjitha llojet e anijeve	0.4
--	-----

3. Taksë e kapitenerisë për dorëzimin e anijeve në portet shqiptare

— Deri në 500 TRN	25
— Nga 500-1000 TRN	20
— Nga 1000-1500 TRN	75
— Nga 1500-2000 TRN	100
— Nga 2000-4000 TRN	160
— Për anije mbi 4000 TRN	250

4. Taksë për dhënien e lejes nga kapiteneria për të drejtën e ushtrimit të radiostacionit

50

5. Taksë për dhënie leje nisjeje nga kapiteneria e portit

— Për anije deri në 500 TRN ... 0,04 Ø për TRN, por jo më shumë se 15 S ..	
— Për anije mbi 500 TRN	15

6. a) Taksë faro feneri për anije
deri në 500 TRN, por jo më pak se 5 S 0,10 USD për TRN

b) Taksë faro feneri për anije
mbi 500 TRN 50 USD për TRN

7. Taksë për protestë detare:

— Për nënshkrimin e saj nga kapiteneria taksa caktohet si vijon:	
— Për anije deri në 500 TRN	30
— Për anije nga 500-1000 TRN	40
— Për anije nga 1000-2000 TRN	45
— Për anije nga 2000-4000 TRN	55
— Për anije mbi 4000 TRN	65

3. Taksë për formalitetet e kryera nga
dogana, shëndetësia dhe autoritetet e tjera

0,3 USD për TRN

- Shënim: 1. Përfshihen nga taksat e mësipërme anijet që transportojnë ndihma shtetërore e humanitare shoqërive të ndryshme bamirëse dhe institucioneve fetare, që jepen falas (pa pagesë).
2. Taksa me zbritje zbatohet kur ka marrëveshje qeveritare ose të miratuara nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.
3. Për anijet e subjekteve fizikë e juridikë shqiptarë pagesa e taksave bëhet në lekë ose në valutë, në raport me realizimin e të ardhurave.
4. Për anijet që prekin portet detare Sarandë, Vlorë e Shëngjin, taksat portuale zbatohen 20 për qind më të ulëta.
5. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve përcaktojnë rregulla për zbatimin e taksave për anijet e subjekteve fizikë ose juridikë shqiptarë.

LIDHJA Nr. 2 NDRYSHOHET SI VIJON:

Lidhja nr. 2

Taksa fikse

TAKSË PËR SHËRBIME KONSULLORE	Lekë
1. Për lëshimin e pasaportave për dalje jashtë shtetit	100
2. Për leje kalimi	50
3. Për vizë të huajve në bazë të marrëveshjeve qeveritare, ose në bazë të reciprocitetit .	
4. Për vizë tranziti të huajve me të drejtë qëndrimi 48 orë në tokën shqiptare	200
5. Për lëshimin e certifikatave për vërtetime ose legalizime certifikatash të lëshuara nga autoritetet e huaja	30
6. Për lëshimin nga përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë të certifikatave të shtetasve ose pasaportave konsullore, si dhe për zgjatjen e afatit të tyre ose të dokumenteve a të akteve të tjera	100

TAKSË PËR QARKULLIMIN E AUTOMJETEVE

A. Për automjetet e huaja

Në lekë

- Për veturat e udhëtarëve për çdo ditë ose pjesë të ditës 40
- Për automjetet për çdo kilometër udhëtar në tokën shqiptare 0.1
- (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogël se 200 lekë për çdo ditë)
- Për kamionët dhe rimorkio kamioni për çdo ton km në tokën shqiptare 0.3
- (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogël se 300 lekë për çdo ditë)
- Kur automjetet kalojnë pa ngarkesë, paguhet 50 për qind e taksës
- Ndryshimi i madhësisë së këtyre taksave nga ndryshimi i kursit të këmbimit lekë me valutë të huaj, nuk konsiderohet rritje e taksave

B. Për automjetet shqiptare

Për mjetet e mallrave

- Për kamion e rimorkio deri në 1 ton 1000 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 1-3 tonë 2000 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 3-5 tonë 3500 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 5-8 tonë 5000 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 8-14 tonë 7000 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 14-20 tonë 8500 lekë
- Për kamion e rimorkio nga 20-25 tonë 9000 lekë
- Për kamion e rimorkio mbi 25 tonë 10000 lekë

Për mjetet e udhëtarëve

- Autoveturat 1000 lekë
- Për mikrobusë deri në 10 vende 2000 lekë
- Për autobusë deri në 30 vende 5000 lekë
- Për autobusë nga 31-50 vende 8000 lekë
- Për autobusë mbi 50 vende 10000 lekë

Për mjete të tjera

- Motoçikleta e triçikël 200 lekë
- Traktorë me goma 3500 lekë
- Për automjetet e transportit të brendshëm dhe teknologjik paguhet 50 për qind e tarifës.